

**PËR DELEGIMIN E PËRFAQËSIMIT TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË PRANË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE DHE
KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 76 të Kushtetutës, neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 7, pika 1, të Rregullores së Kuvendit,

URDHËROJ:

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është autoriteti të cilit i delegohet kompetenca e përfaqësimit të Kuvendit pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.
2. Përfaqësimi pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve bëhet nga vetë Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ose, rast pas rasti, nga punonjës të administratës së Kuvendit të përcaktuar në autorizimin e lëshuar prej Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.
3. Sekretari i Përgjithshëm ose personi i autorizuar prej tij, sipas pikës 2 të këtij urdhri, autorizohet për përgatitjen e parashtrimeve, pretendimeve përfundimtare, ankimeve, si dhe çdo veprim tjetër procedural të nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi në kuadër të përfaqësimit të Kuvendit pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Elisa Spiropali